

STATUT
I
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“OLYMPIA CONSTRUCTIONS GROUP”

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit


1.1. Sot, në datën 05 Janar 2018(Dymijë e tetëmbëdhjetë), personat e mëposhtëm:

- A) Georgia Beziani, e bija e Jorgos dhe e Konstantines, edatëlindjes 24.07.1981, lindurnë Gjirokaster dhe banuese në Tirane, madhore, me zotesinë e plotë për të vepruar, shtetase Shqiptare, mbajtësee pasaportës me Nr. BR7242935.
- B) Anna Bezianni, e bija e Jorgos dhe e Konstantinës, e datëlindjes 27.05.1985, lindur në Gjirokaster dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotesinë e plotë për të vepruar, shtetase Shqiptare, mbajtëse e pasaportës me Nr. BR7242948.
në cilesinë e "Ortakëve Themelues", me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqiperisë, Kodin Civil në fuqi, ligjin Nr. 9901, datë 04.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqërite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit", tani "Qëndra Kombëtare e Biznesit" vendosën të themelojnë shoqërinë tregtare, me perjegjesi te kufizuar, me emerimin "OLYMPIA CONSTRUCTIONS GROUP" SH.P.K.

Neni 2
Objekti

2.1 Objekti i aktivitetit të shoqërisë, pa u kufizuar në to, përfshin aktivitetet:

- Projektim, dizejnim, ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje:




1

- i) objektesh civile, rezidenciale, industriale, tregtare, turistike, bujqësore, projektesh te karakterit publik, qëndrash kulturore dhe arsimore, spitalore, sportive, si dhe kompletimi i tyre me instalimin e nevojshëm hidrosanitar, elektrik etj.,
- ii) rrugësh (si dhe riparimi i infrastrukturës rrugore), hekurudhash, urash.
- iii) hidrocentralesh, pusesh, ujësjellësash, i depove të ujësjellësave, kanalesh e impiantesh vaditëse, punime mbrojtje të sistemit hidraulik, impiantesh të sistemit të ujit, digash, veprash të veçanta, punimesh speciale, punimesh mbi dhe nëntokesore, izolimesh mbi dhe nëntokësore nga ujërat, shpime gjeologo-inxhinierike, shpime për ujë. Ndërtim i linjave të shfrytëzimit e pastrimit të ujit të pijshëm.
- Punime shërbimi në sipërfaqe të gjelbërtë parqe-pyje, mirëmbajtje dhe zhvillim i dekorit në mjedise urbane, ndricim dhe sinjalizim urban.
 - Zbatim punimeve.
 - Punime të dheut, tarracimeve, punimeve nentokësore, punime hidraulike, elektrike, gipsi, suvatime etj.
 - Konceptim i dizejnimeve te projekteve urbane te integruar, dizejnim detajeve dhe supervizim projektesh, qe perfshin monitorimin, inspektimin dhe raportimin e aktiviteteve ne supervizim.
 - Importim-eksportim dhe tregtim i të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, automjeteve të tipeve të ndryshme, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme, të karakterit publik, industrial, bujqësor, tregtar, kulturor, sportiv, të sherbimeve, pjesë kembimi, goma të ndryshme, bateri automjetesh etj, në territorin e Republikës së Shqiperisë dhe jashtë saj.
 - Hapjen e zyrave imobiliare dhe informacionit per shitjen dhe blerjen e pasurive te paluajtshme, dhenien e tyre me nenkontraktim dhe me qera etj.
 - Pjesmarrja e shoqerise në tendera, koncesione apo në çdo procedurë tjetër konkurimi kombëtar apo ndërkombëtar, vetëm apo në bashkepunim me subjekte të tjere pa kufizim përsa i përket objektit sa mësipër.
 - Shoqëria mund te kryejë aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për qëllimin e shoqërisë.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

3.1

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit ku



Asambleja e Ortakëve, sipas kuorumi të përkates vendos ndryshe.

3.2 Shoqëria "OLYMPIA CONSTRUCTIONS GROUP" SH.P.K. gjëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKB-se.

Neni 4:
Selia

4.1 Zyra qendrore e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga "Dervish Hima", Pallati Leskova, Ap. 65, Tiranë

4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijoje dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit te Republikës se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridikSIONIT te vendit perkates.

KREU II
KAPITALI

Neni 5
Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000(njeqinde mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortakja themeluese Georgia Beziani: Zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhjete mijë) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. Ortakja themeluese Anna Beziani: Zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhjete mijë) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqerisë mund të zmadhohet nëpermjet nënshkrimit të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Ortakët e shoqerisë i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjellta me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykates përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqerisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkoen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të shoqerisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- kontributit në kapitalin e shoqerisë;
 - shitblerjes;
 - trashëgimisë;
 - dhurimit;
 - çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërise.

- 8.2 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërise që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - ç) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
 - g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - gj) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
 - h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 8.7 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investimet;
 - ç) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 9
Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kërkesa nga ortakët e pakicës

- 10.1 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat Asambleja e Përgjithshme duhet të marrë një vendim.
Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 9 të këtij Statuti.
- 10.2 Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
a) të ngrejë padi në gjykatë, për të dekluaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse Administratori nuk përbush kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tij.
- 10.3 Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, Administratori njofton përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 9 të këtij Statuti.



**Neni 11
Kuorumi**

- 11.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 11.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.
- 11.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 12
Marrja e vendimeve**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve
 - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori, përfshirë përgatitjen e Pasqyrave Financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- 12.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.



Neni 13
Përjashtimi nga e drejta e votes

- 13.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 13.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një person i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


Neni 14
Administrimi

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si Administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 14.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

Të dhënat e identifikimit

Georgia Beziani, e bija e Jorgos dhe e Konstantines,
e datëlindjes 24. 07. 1981,
lindur në Gjirokaster, dhe banuese ne Tirane,
mbajtëse e pashaportës me Nr. BR7242935.

Specimeni i nënshkrimit:



Neni 15
Kompetencat e Administratorit

- 15.1 Administratori, ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - c) përgatis dhe nënshkruajë Pasqyrat Financiare vjetore dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - d) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - e) raportoj përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) kryej detyra të tjera të përcaktuara në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në Statut.
- 15.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas Pasqyrave Financiare vjetore apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas rregjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që ka vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 15.3 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e Administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.



Neni 16
Përgjegjësitë e Administratorit

- 16.1 Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 16.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit 9901 datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 16.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 16.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1,2 dhe 3 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruar.
- 16.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;



- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

KREU IV
VITI FINANCAR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 17
Viti Financiar

- 17.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë Financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

Neni 18
Shpërndarja e fitimeve

- 18.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të dekluaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
- 18.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendifit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 18.3 Administratori lëshon një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkasat e pikës 2 të këtij nenit, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kritere, Administratori nuk mund ta lëshojë këtë çertifikatë.
- 18.4 Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e çertifikatës së aftësisë paguese.

**KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 19
Prishja dhe likuidimi**

- 19.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - c) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
 - d) me Vendim të Gjykatës;
- 19.2 Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidues dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuiduesit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër". Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 20
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

- 20.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare."

Neni 21
Baza Ligjore

- 21.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në perputhje të plete me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 22
Mosmarrëveshjet

- 22.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund te lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të zgjidhennga Gjykata kompetente Shqiptare.

**O R T A K E T
E
SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"OLYMPIA CONSTRUCTIONS GROUP " SH.P.K."**

Georgia Beziani

Anna Beziani